



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRI**

URDHER

PER

**SHPALLJEN E THIRRJES PER FINANCIMIN E IAL-VE PUBLIKE, PER PROJEKTE
TE PERBASHKETA NE KUADER TE NDERKOMBETARIZIMIT TE PROGRAMEVE
TE STUDIMIT, PER VITIN AKADEMIK 2022-2023.**

Ne mbështetje te nenit 102 te Kushtetutes, te nenit 110, té ligjit nr.80/2015 “Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larté ne Republiken e Shqiptirisé”, si dhe Vendimin nr. 75, date 12.02.2018 “Per miratimin e modelit té financimit te buxhetit per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor” té ndryshuar,

URDHEROJ:

1. Shpalljen e thirrjes per financimin e projekteve ne kuader te nderkombiitarizimit té programeve te studimit per IAL-publike, nga fondet e miratuara per vitin 2022, ne programin e arsimit té larte (09450).
2. Drejtimet e thirrjes pér financim:
 - a) Perzhvillimin, permiresimin dhe pérafrimin e kapacitetve akademike té mésimdhénies, per te tre ciklet e studimit. Shpenzimet per kété kategori projektesh do tti perballohen me fondet “grandi i mesimdhénies”, ne varési me projekt-propozimet e paraqitura nga IAL-te publike.
 - b) Perzhvillimin e infrastrukurés akademike, didaktike dhe kerkimore te IAL-ve publike, ne kuadér te marréveshjeve té perbashketa me institucionet e vendeve te BE-se dhe tti tjere. Ne kété drejtim pérfshihen projektet per investime kapitale te cilat kane qellim zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve té reja akademike dhe laboratorike, né funksion te realizimit te programeve té pérbashketa.
3. Vlera e financimit nga fondet e miratuara pér ministriné e Arsimit dhe Sportit, sipas drejtimeve te thirrjes per vitin 2022, éshte sa vijon:
 - projektet sipas drejtimet te thirrjes, germa “a”, ne shumén 150,000,000 leke.
 - projektet sipas drejtimet té thirrjes, germa “b”, ne shumén 218,000,000 leke.
4. Per projektet e infrastruktures ndertimore, cikli i financimit te tyre parashikohet jo mé shume se 2 (dy) vite buxhetore, pérkatesisht viti 2022 dhe 2023.